

Ivan Todorovski

# UDHËZUES I PROCEDURËS PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

# Përmbajtja

Hyrje .....	5
1. Kapitulli i parë – Instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve.....	6
1.1 Kuadri ligjor për mbrojtjen e sinjalizuesve në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	6
1.2 Çfarë nënkuptohet me termin sinjalizues .....	6
1.3 Ligji për mbrojtjen e denoncuesve.....	7
1.4 Rregullorja për raportimin e brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016 .....	9
1.5 Rregullorja për raportimin e mbrojtur të jashtëm, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016 .....	10
1.6 Rregullorja me udhëzime për miratimin e akteve të brendshme për raportim të brendshëm të mbrojtur në subjektin juridik në sektorin privat, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016 .....	10
1.7 Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve .....	10
1.7.1 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) .....	10
1.7.2 Direktiva e BE-së 2019/1937 .....	11
1.7.3 Rekomandim i Këshillit të Evropës për vitin 2014 për mbrojtjen e sinjalizuesve.....	11
1.7.4 Shembuj të rasteve të sinjalizuesve në nivel ndërkombëtar .....	12
2. Kapitulli i dytë – Raportimi i brendshëm i mbrojtur .....	15
2.1 Raportimi i brendshëm i mbrojtur – procedura .....	15
2.2 Shembuj praktikë .....	18
3. Kapitulli tre – Raportimi i jashtëm i mbrojtur .....	20
3.1 Raportimi i jashtëm i mbrojtur – procedura .....	20
3.2 Shembuj praktikë.....	22
4. Kapitulli i katërt – Raportimi publik i mbrojtur .....	23
4.1 Raportimi publik i mbrojtur – procedura .....	23
4.2 Shembuj praktikë .....	24
5. Kapitulli i pestë – Mbrojtja e sinjalizuesve .....	25
5.1 Mbrojtja e të dhënave dhe identitetit të sinjalizuesve .....	25
5.2 Ofrimi i mbrojtjes sinjalizuesve.....	25
5.2.1 Shembuj praktikë.....	27
5.3 Mbrojtja gjyqësore.....	28
5.4 Keqpërdorim i raportimit të sinjalizuesve .....	28
6. Kapitulli i gjashtë – Statistikat për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve .....	30

Përkrahur nga:



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos  
këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

---

## Hyrje

---

Udhëzuesi është i dedikuar për trajnim dhe përdorim nga personat e autorizuar për pranimin e informacioneve nga sinjalizuesit. Ai është i ndarë në pesë kapituj tematikë dhe përmban një pasqyrë të shkurtër të legjislacionit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve, shpjegon procedurën e pranimit të informacioneve nga sinjalizuesit dhe veprimet e personave të autorizuar në institucionet publike, si dhe format dhe procedurat e parashikuara për mbrojtjen e sinjalizuesve. Për më tepër, udhëzuesi përmban shembuj ilustrues të rasteve nga sinjalizues në nivel ndërkombëtar, si dhe skenarë të mundshëm të zhvilluar për atë se cilat raste trajtohen dhe u jepet statusi i sinjalizuesve në përputhje me aktet ligjore pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Raportimi i mbrojtur në Republikën e Maqedonisë së Veriut është prezantuar dhe rregulluar për herë të parë që nga viti 2015, përmes miratimit të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Raportimi i mbrojtur është një nga mekanizmat efektivë në luftën kundër korrupsionit dhe krimin, dhe lejon raportimin e operacioneve të paligjshme në institucionet e sektorit publik dhe privat.

Raportimi i mbrojtur është një procedurë e rregulluar ligjërisht, që siguron konfidencialitetin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Raportimi i mbrojtur bëhet duke paraqitur një raport tek personat e autorizuar në institucione për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, të cilat më tej i përpunojnë dhe marrin masat e nevojshme për të mbrojtur sinjalizuesit. Prandaj, personat e autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve kanë një rol të veçantë në procedurën e raportimit të mbrojtur dhe informacioni i dhënë nga sinjalizuesit/sinjalizueset mund të jetë një bazë solide për fillimin e një kontrolli të brendshëm në institucion ose kontroll administrativ, pas sigurimit të dokumenteve dhe të dhënave nga institucionet e tjera, të cilat mund të përfundojnë me fillimin e një procedure penale ose procedurë tjetër për përcaktimin e përgjegjësisë, ndërsa qëllimi është mbrojtja e së mirës të përbashkët dhe interesit publik.

Në rastet e raportimit të mbrojtur, është jashtëzakonisht e rëndësishme që procedura e raportimit dhe përpunimit të informacionit të raportuar të kryhet vazhdimisht dhe që për sinjalizuesit/sinjalizueset të sigurohet mbrojtja e duhur. Shpesh informacioni i dhënë i referohet veprimeve të rënda të paligjshme dhe duhet të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligj dhe akte nënligjore (rregullore). Kjo është e nevojshme për të mos kompromentuar informacionin e dhënë dhe keqpërdorimin e tij të mëtejshëm, si dhe për të mos rrezikuar sigurinë personale të sinjalizuesve ose të afërmeve të tyre.

Teksti i mëposhtëm i Udhëzuesit do të përshkruajë në detaje mënyrën dhe hapat e nevojshëm për veprim të personave përgjegjës për pranimin e raporteve nga sinjalizuesit.

# 1 Kapitulli i parë – Instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve

## 1.1 Kuadri ligjor për mbrojtjen e sinjalizuesve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Kuadri ligjor kombëtar për mbrojtjen e sinjalizuesve në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga:

- Ligji për mbrojtjen e denoncuesve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 196/2015, 35/18 dhe 257/2020) dhe rregulloret për zbatimin e tij.
- Rregullore për raportimin e brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016,
- Rregullore për raportimin e mbrojtur të jashtëm, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46 të datës 8 mars 2016 dhe
- Rregullore për udhëzime për miratimin e akteve të brendshme për raportim të brendshëm të mbrojtur në subjektin juridik në sektorin privat, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016.

## 1.2 Çfarë nënkuptohet me termin sinjalizues

Sinjalizuesit janë persona që janë të punësuar ose të angazhuar në institucione publike ose në mënyrë tjetër, përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi afarist ose lloj tjetër marrëveshje që lidhet me një institucion të caktuar, kur kuptojnë për veprime të paligjshme ose jo-etike që ndodhin brenda institucioneve dhe që rrezikojnë dhe dëmtojnë drejtpërdrejt interesin publik, dhe këto informacione i raportojnë përmes kanaleve të krijuara për raportim te persona të autorizuar për pranimin e raporteve nga sinjalizuesit në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve.

Shembull i një informatori është personi që punon në një institucion publik ose në një kompani private. Gjatë kryerjes së detyrave të punës në vendin e tij/saj të punës, ai/ajo sheh ose kupton për aktivitete korruptive ose për aktivitete të tjera të paligjshme që kryhen në institucion. Ai beson se kjo është shumë e rëndësishme për interesin publik në vend dhe se institucionet kompetente duhet të reagojnë. Nëse ai person vendos të raportojë rastin, mund ta bëjë këtë në mënyrë anonime ose konfidenciale me një identitet të njohur në institucionin ku punon ose në institucione të tjera (institucione për raportim të jashtëm të mbrojtur (KSHPK,

MPB, Avokati i Popullit, PPRMV) nëse raporti është kundër personit përgjegjës të institucionit, dhe kështu bëhet sinjalizues dhe mbrohet me ligj. Ligji për mbrojtjen e denoncuesve siguron mbrojtje nga çdo lloj shkeljeje të ligjit ose, siç thuhet, veprim ose rrezik nga veprimi i dëmshëm ndaj personit që raporton, me qëllim të kryerjes së raportimit të mbrojtur, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Çdo institucion është i detyruar, në përputhje me ligjin, të caktojë një person për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, i cili njëkohësisht sipas ligjit është i detyruar t'i mbajë sekret të dhënat që përmban raporti lidhur me identitetin e sinjalizuesit/sinjalizueses.

## 1.3 Ligji për mbrojtjen e denoncuesve

Sipas Ligjit, raportimi i mbrojtur është një raportim ose zbulim që përcjell një dyshim ose njohuri të arsyeshme se një veprim i dënueshëm, jo etik ose i paligjshëm apo i papranueshëm, që cenon ose kërcënon interesin publik është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet<sup>1</sup>.

Kategoritë e personave që mund të paraqiten në cilësinë e sinjalizuesve janë:

- personi që ka krijuar marrëdhënie pune për një kohë të pacaktuar ose të caktuar në institucion, përkatësisht personi juridik për të cilin raporton;
- kandidati për punësim, kandidati vullnetar ose praktikanti në institucionin ose subjektin juridik për të cilin ai/ajo aplikon;
- personi që është ose ka qenë vullnetar ose praktikant në institucion, përkatësisht personi juridik për të cilin ai/ajo raporton;
- personi i cili, për çfarëdolloj arsye, është ose ka qenë i angazhuar në kryerjen e punës nga institucioni, përkatësisht personi juridik për të cilin ai/ajo raporton;
- personi i cili, për çfarëdolloj arsye, është ose ka qenë në një marrëdhënie afariste ose marrëdhënie tjetër bashkëpunimi me institucionin, përkatësisht personin juridik për të cilin ai/ajo raporton;
- personi që përdor ose ka përdorur shërbime në institucion, përkatësisht në personin juridik në sektorin publik dhe privat për të cilin raporton.

Ligji njih tri lloje të raportimit të sinjalizuesve:

- raportim i brendshëm i mbrojtur,
- raportim i jashtëm i mbrojtur dhe
- raportim publik i mbrojtur.

Raportimi i brendshëm i mbrojtur kryhet nga sinjalizuesi në institucion, përkatësisht në personin juridik, ku ekziston dyshimi ose informacioni se është kryer, po kryhet ose do të kryhet një veprë e ndëshkueshme, trajtim jo etik ose veprim tjetër i paligjshëm ose i papranueshëm që cenon ose rrezikon interesin publik. Sinjalizuesit mund të raportojnë gojarisht në procesverbal ose me shkrim tek një person i autorizuar nga personi udhëheqës në institucion, përkatësisht në personin juridik për të cilin raporton.

Nga ana tjetër, raportimin e jashtëm të mbrojtur sinjalizuesi mund ta kryejë edhe duke raportuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurorinë Publike kompetente, Komisionin

<sup>1</sup> Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, etj. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 196/2015, 35/18,257/20

Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Avokatin e Popullit ose institucione të tjera kompetente, përkatësisht persona juridikë, nëse raportimi ka të bëjë drejtpërdrejt ose tërthorazi kundër personit udhëheqës në institucionin për të cilin raportohet<sup>2</sup>.

Përveç mënyrave të përcaktuara me ligj të paraqitjes së raportimit (me shkrim, me postë ose me e-mail, gojarisht në procesverbal) në KSHPK, raportimet mund të dorëzohen edhe përmes zgjidhjes softuerike për raportimet e sinjalizuesve, e cila është instaluar në ueb faqen e saj [www.dksk.mk](http://www.dksk.mk) Ky mjet mundëson një mënyrë të sigurt (të koduar – të mbrojtur) të raportimit dhe komunikimit midis sinjalizuesit/sinjalizueses dhe personit të autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve. Sinjalizuesit/sinjalizueset, duke përdorur aplikacionin në dispozicion, mund të paraqesin raportim në KSHPK në një mënyrë të thjeshtë, dhe në të njëjtën kohë të jenë në komunikim me personin e autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve në KSHPK deri në përfundimin e lëndës së tyre. Të gjithë sinjalizues-it/sinjalizueset duhet të instalojnë aplikacionin në kompjuterin e tyre personal dhe të kryejnë më tej të gjithë komunikimin në një format të mbrojtur me KSHPK-në. Aplikacioni, së bashku me udhëzimin<sup>3</sup> për përdorimin e tij, mund të shkarkohen nga faqja e internetit e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.<sup>4</sup> Përveç KSHPK-së, raportim i tillë mund t'u dorëzohet institucioneve të tjera për raportim të jashtëm të mbrojtur, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë Publike, Avokatit të Popullit, Inspektorateve Shtetërore.

Është e rëndësishme të theksohet se Ligji parashikon mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesve për të parandaluar hakmarrjen ose çdo pasojë tjetër të dëmshme ndaj tij/saj, duke ndaluar zbulimin ose duke mundësuar zbulimin e identitetit të sinjalizuesit/sinjalizueses pa pëlqimin e tij/saj, përveç kur kjo kërkohet me vendim gjyqësor kur është e nevojshme, për t'u zhvilluar procedura para një autoriteti kompetent. Gjithashtu parashihet edhe mbrojtje gjyqësore nga çdo lloj shkeljeje e së drejtës, gjatë përcaktimit të përgjegjësisë, sanksionit, ndërprerjes së marrëdhënies së punës, pezullimit nga puna, transferimit në një punë tjetër që është më pak e favorshme, diskriminimit ose veprimit të dëmshëm apo rrezikut nga veprime të dëmshme për shkak të raportimit të brendshëm dhe të jashtëm të mbrojtur ose raportimit publik të mbrojtur.

Një tjetër shënim i rëndësishëm është se ligji parashikon gjithashtu dispozita për kundërvajtje<sup>5</sup> dhe gjoba në lidhje me mosrespektimin dhe mospërputhjen e zbatimit të ligjit dhe procedurat e parashikuara për përpunimin e raporteve të sinjalizuesve dhe mbrojtjen e tyre përkatëse.<sup>6</sup>

<sup>2</sup> Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, etj. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 196/2015, 35/18,257/20

<sup>3</sup> <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/07/Upatstvo-ukazuvaci.pdf>

<sup>4</sup> <https://dksk.mk/апликација-за-укажувач/каи/>

<sup>5</sup> Ligji për mbrojtjen e denoncuesve Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 196/2015, 35/18, 257/20. Nenet 16-23

<sup>6</sup> Për shembull, gjobë në vlerë prej 100 deri në 500 EUR në kundërvlerë në denarë do t'i vendoset personit të autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, përkatësisht personit udhëheqës në institucion, përkatësisht personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 paragrafin (4), gjegjësisht nuk vepron mbi raportimin dhe nuk respekton procedurat e përcaktuara me aktin për raportim të brendshëm. Ose, gjobë në vlerë prej 5,000 deri në 10,000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i vendoset institucionit, përkatësisht personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 5 paragrafin (3), gjegjësisht autoriteteve ose institucioneve të cilave sinjalizuesi ka kryer raportim të jashtëm të mbrojtur që nuk kanë vepruar brenda kompetencave të tyre, lidhur me raportimin dhe nuk kanë mbrojtur të dhënat personale, përkatësisht të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit.

## 1.4 Rregullorja për raportimin e brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016

Kjo rregullore, parashikon raportimin e brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik. Rregullohet mënyra e emërimit të personit përgjegjës për raportimet e sinjalizuesve, statusi i tij në institucion dhe pajisjet teknike dhe mënyra e trajtimit të raportimit të pranuar nga sinjalizuesit.

Përkatësisht, Rregullorja përcakton kushtet për emërimin e personit të autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, ku personi udhëheqës gjatë emërimit të një personi të autorizuar udhëhiqet nga sa vijon:

- të jetë person i punësuar në vend pune udhëheqës;
- të ketë kryer arsimin e lartë në fushën e shkencave juridike, të sigurisë ose ekonomike;
- të posedojë certifikatë sigurie me shkallë në varësi të shkallës së klasifikimit të informacionit në dispozicion të institucionit për të cilin është emëruar personi;
- të ketë përvojë pune në trajtimin e raporteve, përkatësisht ankesave, punëve me palët, kryerjen e mbikëqyrjes, ndërmarrjen e veprimeve hetimore ose inspektuese, kryerjen e revizionit ose kontrollit të brendshëm ose përvojë tjetër pune në kryerjen e detyrave në konfidencialitet, pranimin dhe dërgimin e të dhënave në institucione të tjera dhe udhëzimin e palëve.

Gjithashtu, personi udhëheqës duhet të sigurojë pavarësinë dhe vazhdimësinë e punës dhe kushtet e përshtatshme të punës për personin e autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, me qëllim ruajtjen e standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes gjatë trajtimit të informacionit të klasifikuar.

Në përputhje me rrethanat, personi udhëheqës, personit të autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve i siguron hapësirë dhe pajisje për punë si më poshtë:

- hapësirë pune, e përshtatshme për pritjen e palëve;
- kompjuter i dedikuar, i siguruar me një emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik
- krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të, me lidhje interneti dhe një kuti postare të posaçme elektronike të pajisur me një emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik të krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të;
- vulë katrore speciale për pranim;
- regjistër i veçantë i të dhënave;
- kuti postare e veçantë;
- linjë telefonike të veçantë;
- sirtar për dokumentacionin;
- pajisje të tjera për zbatimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhëna të tjera në lidhje me sinjalizuesit dhe raportimet, duke marrë parasysh rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloret për mbrojtjen e informatave të klasifikuara.

## 1.5 Rregullorja për raportimin e mbrojtur të jashtëm, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016

Kjo rregullore parashikon raportimin e jashtëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik. Rregullohet mënyra e emërimit të personit përgjegjës për raportimet e sinjalizuesve, statusi i tij në institucion dhe pajisjet teknike, mënyra e trajtimit të raportit të pranuar nga sinjalizuesi/sinjalizuesja dhe shpërndarja në një institucion tjetër kompetent..

## 1.6 Rregullorja me udhëzime për miratimin e akteve të brendshme për raportim të brendshëm të mbrojtur në subjektin juridik në sektorin privat, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 46, datë 8.03.2016

Me këtë rregullore përcaktohen udhëzimet për miratimin e akteve të brendshme për raportimin e brendshëm të mbrojtur në subjektin juridik në sektorin privat. Personat juridikë udhëzohen, gjatë miratimit të rregullave të brendshme për raportim të mbrojtur, të marrin parasysh dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, kryesisht në lidhje me:

- qasjen te një person, përkatësisht vendin për raportim të brendshëm të mbrojtur,
- qasjen në aktin e brendshëm për raportimin e brendshëm të mbrojtur për të gjithë punonjësit në subjektin juridik.

Më tej parashikohet pavlefshmëria e dispozitave në aktet dhe marrëveshjet që rregullojnë të drejtat e marrëdhënies së punës dhe angazhimet e punës, që ndalojnë raportimin e dyshimit ose njohurive për një veprim të dënueshëm ose veprim tjetër të paligjshëm ose të papranueshëm, i cili cënon ose kërcënon interesin, sigurinë dhe mbrojtjen publike ose një raportim të tillë përcaktohet si shkelje e dispozitave mbi konfidencialitetin, lojalitetin dhe profesionalizmin.

Gjithashtu rregullohet edhe mbrojtja e sinjalizuesve dhe e një personi të afërt me të, nga çdo lloj shkeljeje të së drejtës ose veprimit të dëmshëm ose rrezikut nga veprime të dëmshme për shkak të raportimit.

## 1.7 Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve

### 1.7.1 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e miratuar në tetor 2003 me Rezolutën 58/4 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, është instrumenti i vetëm detyrues ndërkombëtar kundër korrupsionit. Konventa u nënshkrua nga Republika e Maqedonisë<sup>7</sup> më 18 gusht 2005 dhe u ratifikua në prill 2007 dhe është në fuqi që nga 13 maji 2007.

<sup>7</sup> Shteti zyrtarisht e ndryshoi emrin në vitin 2019, sipas Marrëveshjes se Prespës. Shumë akte juridike që ishin miratuar para kësaj date janë akoma në fuqi dhe kanë emrin e mëparshëm të shtetit në titujt e tyre. Përdorimi i emrit të mëparshëm në këtë dokument është për shkak të precizitetit juridik.

Neni 33 i Konventës parashikon që – “Çdo shtet palë do të marrë parasysh përfshirjen në sistemin e tij ligjor të brendshëm masat e duhura për të siguruar mbrojtje kundër çdo trajtimi të pajustificuar për çdo person që, në mirëbesim dhe mbi baza të arsyeshme, raporton tek autoritetet kompetente çdo fakt në lidhje me shkeljet e përcaktuara në përputhje me këtë Konventë”.

Konventa gjithashtu ka një mekanizëm për rishikim, me qëllim monitorimin e zbatimit të saj. Mekanizmi për rishikimin e zbatimit të Konventës është krijuar dhe po zbatohet në përputhje me nenin 63 të Konventës dhe Rezolutën 3/1 të miratuar nga Konferenca e Shteteve palë në Konventë, më 13 nëntor 2009.

Rishikimi i zbatimit të Konventës është një proces rishikimi ndërshtetëror, që ndihmon Shtetet palë të zbatojnë në mënyrë efektive dispozitat e Konventës. Secila nga Shtetet palë i nënshtrohet rishikimit nga dy Shtete të tjera palë, njëra prej të cilave është nga i njëjti grup rajonal. Shtetet- palë që kryejnë rishqyrtimin zgjidhen me short.

Shqyrtimi i zbatimit të Konventës – Cikli i dytë (Kapitujt II dhe V) për Republikën e Maqedonisë së Veriut vëren si sukses dhe praktikë të mirë Miratimin e Ligjit specifik në vitin 2015, LMI, Ligji për mbrojtjen e denoncuesve.

### 1.7.2 Direktiva e BE-së 2019/1937

Në kuadër të Bashkimit Evropian, dokumenti më i rëndësishëm është Direktiva 2019/1937 e miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së më 23 tetor 2019. Sipas Direktivës, personat që punojnë ose janë në kontakt me një organizatë publike ose private në kontekstin e aktiviteteve të tyre në lidhje me punën, shpesh janë të parët që bëhen të vetëdijshëm për kërcënimet ose dëmtimet e interesit publik që lindin në atë kontekst. Me raportimin e shkeljeve të së drejtës së Bashkimit Evropian, të dëmshme për interesin publik, këta persona veprojnë si “sinjalizues” dhe kështu luajnë një rol të rëndësishëm në raportimin dhe parandalimin e shkeljeve të tilla dhe mbrojtjen e mirëqenies së shoqërisë. Megjithatë, theksohet se sinjalizuesit e mundshëm shpesh dekurajohen të raportojnë se çfarë i shqetëson ata ose nëse dyshojnë nga frika e hakmarrjes. Prandaj, në këtë kontekst, njihet rëndësia e sigurimit të mbrojtjes së balancuar dhe efektive të sinjalizuesve.

Përveç të punësuarve, Direktiva mbron sindikatat, organizatat e shoqërisë civile ose personat që ndihmojnë ose lidhen me to, kompanitë në të cilat ata punojnë, aksionarët, furnizuesit, konsulentët dhe të vetë-punësuarit. Direktiva siguron mbrojtje për ata që janë të lidhur ose ndihmojnë sinjalizuesit. Ndërsa Direktiva inkurajon përdorimin e kanaleve zyrtare institucionale, nuk ka kufizime të bazuara në kontekst. (Nenet 4, 19). Gjithashtu parashihet ndalimi i plotë i çdo ngacmimi të sinjalizuesve në vendin e punës. Direktiva njeh kanalet e raportimit të brendshëm dhe të jashtëm. Direktiva parashikon gjithashtu masa për mbrojtje kundër hakmarrjes dhe masa për mbështetjen e sinjalizuesve (neni 19-21).

### 1.7.3 Rekomandim i Këshillit të Evropës për vitin 2014 për mbrojtjen e sinjalizuesve

Rekomandimi i Këshillit të Evropës u miratua në Komitetin e Ministrave, më 30 prill 2014 dhe rekomandon që Shtetet anëtare të krijojnë një kornizë normative, institucionale dhe gjyqësore për mbrojtjen e personave që, në kontekstin e punësimit të tyre, raportojnë ose

zbulojnë informacion mbi kërcënimet ose shkeljet e interesit publik. Përveç këtij rekomandimi, janë krijuar një sërë parime që konfirmojnë se liria e shprehjes dhe e drejta për të kërkuar dhe pranuar informacione janë me rëndësi fundamentale për funksionimin e një demokracie të vërtetë. Sipas përcaktimit të dhënë në rekomandim, “sinjalizues” është çdo person që raporton ose zbulon informacion në lidhje me rrezikimin ose shkeljen e interesit publik në kuadër të punësimit të tij/saj, në sektorin publik ose privat, ndërsa raportimi ose zbulimi i informacioneve me interes publik është “raportimi ose zbulimi i informacioneve në lidhje me veprimet dhe mosveprimet që rrezikojnë ose dëmtojnë interesin publik.” Raportimi mund të jetë i brendshëm në kuadër të një organizate ose ndërmarrje, ose një organi të jashtëm.<sup>8</sup>

#### 1.7.4 Shembuj të rasteve të sinjalizuesve në nivel ndërkombëtar

##### Rasti i Mark Felt

Një nga rastet më të famshme të sinjalizuesve në Shtetet e Bashkuara dhe në botë është çështja Watergate, në të cilën për më shumë se tridhjetë vjet, njerëzit kanë speculuar për identitetin e pseudonimit (sinjalizuesit) “Deep Throat”, sinjalizuesve sekretë Bob Woodward dhe Carl Bernstein, gazetarëve të Washington Post, që ekspozuan skandalin Watergate në 1972. Në vitin 2005, identiteti i Felt u zbulua<sup>9</sup> përfundimisht. Felt ishte drejtori i asociuar i FBI-së, i dyti në komandë të Byrosë, kur zbuloi informacion në lidhje me përfshirjen e Presidentit Nikson në çështjen Watergate. Ndërsa Watergate përfundimisht çoi në dorëheqjen e Presidentit dhe dënimet me burg për dy nga zyrtarët më të lartë të Niksonit, pasi u zbulua identiteti i Felt, historianët debatuan nëse ai veprroi si sinjalizues për shkak të shqetësimeve etike apo ishte thjesht një përpjekje për të fituar postin e lartë në Byro. Megjithatë, misterit shumë dekadash rreth identitetit të tij dhe implikimet e veprimeve të tij kanë përmasa historike dhe e vendosin atë në vendin e parë të sinjalizuesve të famshëm në historinë e Shteteve të Bashkuara dhe më gjerë.<sup>10</sup>

##### Rasti i Antoine Deltour dhe Raphaël Halet (LuxLiks)

Dyshja më e famshme që doli publikisht me informacione në lidhje me marrëveshjet e favorshme tatimore, të dhëna për korporatat multinacionale nga Qeveria e Luksemburgut. Pas dorëheqjes nga PwC në vitin 2010, Antoine Deltour doli në publik me marrëveshjet që ish-firma e tij kishte negociuar me autoritetet tatimore të Luksemburgut.<sup>11</sup> Rafael Hallett fillimisht ishte anonim, por me rritjen e skandalit, u shfaq së bashku me Deltour dhe Édouard Perrin, një gazetar francez, i cili gjithashtu bëri dokumentar në lidhje me rastin në vitin 2012. Megjithatë, të dy ata u përballën me pasoja të rënda për shkak të raportimit të tyre. Fillimisht ata u akuzuan për vjedhje të dokumenteve nga autoritetet e Luksemburgut, por më vonë u liruan dhe iu dha statusi i sinjalizuesve. Hallett gjithashtu apeloj në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg ku fitoi çështjen kundër shtetit të Luksemburgut, i cili duhet t'i paguajë dëmshpërblim për shkeljen e së drejtës së tij të shprehjes.<sup>12</sup>

8 Rekomandim CM/Rec (2014) 7 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve

9 <https://stfrancislaw.com/blog/10-most-famous-whistleblowers/>

10 <https://wemoral.com/blog/mark-felt-deep-throat-the-watergate-scandal-whistleblower>

11 <https://whistleblowingnetwork.org/WIN/media/files/win-case-summary-deltour.pdf>

12 <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-223259%22%7D>

##### Çështja Zuzana Hlavkova

Një nëpunëse civile e re dhe ambicioze vendos të ekspozojë korrupsionin e pretenduar në Ministrinë Sllovaqe të Punëve të Jashtme gjatë kohës kur ka punuar në kryesimin Sllovak me BE-në, në vitin 2016. Hlavkova ka dyshuar kur këshilltarja e re për media ndryshoi plotësisht fushëveprimin e disa prej projekteve të departamentit në të cilin punonin. Për shembull, vetëm buxheti për dy koncerte është rritur me disa qindra mijëra euro. Ajo gjithashtu donte të organizonte një ceremoni të shtrenjtë ku do të zbulohej logoja e Presidencës Sllovaqe me BE-në, një ngjarje që dukej se kishte më shumë rëndësi politike partiake sesa kombëtare.

Zakonisht sipas rregullave të prokurimit publik në Sllovakia, prokurimi publik i nënshtrohet ofertave të hapura, por në këtë rast u aplikua një përjashtim, kështu që një kompanie të miratuar më parë iu dha kontrata me çmime disa herë më të larta se normalja, ndërsa buxhete shtesë u siguruan drejtpërdrejt përmes Ministrisë dhe jo përmes organit përgjegjës organizativ. Hlavkova kështu konfirmoi dyshimet dhe nuk mund të ishte inferiore dhe të ishte pjesë e këtyre parregullsive, kështu që dha dorëheqje nga Ministria dhe informoi Ministrinë për prokurimet kontestuese.

Qeveria mohoi pretendimet e Hlavkovës, madje e kërcënoi me një padi dhe u kritikua publikisht për akuzat e bëra kundër vendit të saj, por mbështetja publike për të, u rrit dita ditës dhe mijëra njerëz nënshkruan peticion në mbështetje të saj. Pas largimit nga Qeveria, ajo vazhdoi të punonte si aktiviste në mbështetje të sinjalizuesve.<sup>13</sup>

##### Rasti i Jacob Guja

Jacob Guja nga Moldavia ka punuar si shefi i departamentit të shtypit në Zyrën e Prokurorit Publik. Guja zbuloi përpjekjet e zyrtarëve të lartë politikë për të ndikuar në gjyqësor. Pas thirrjes publike të Presidentit Voronin në vitin 2003 për t'i dhënë fund korrupsionit, përfshirë përpjekjet e zyrtarëve publikë për të ushtruar presion mbi zyrtarët për zbatimin e ligjit, Guja i përcolli letrat e pranuar nga Zyra e Prokurorit Publik, në një gazetë. Korrespondenca tregoi se zyrtarë të lartë kanë ushtruar presion ndaj prokurorëve për t'i dhënë fund procedimit penal kundër katër policëve, që ishin nën hetim për dyshimin për arrestim të paligjshëm dhe keqtrajtimit të të arrestuarve. Pas zbardhjes së rastit, Adderall u pushua nga puna për zbulimin e dokumenteve konfidenciale. Ai më pas ngriti një padi kundër shkarkimit të tij të padrejtë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila vendosi që Moldavia kishte shkelur të drejtën e Guës për lirinë e shprehjes përmes informimit dhe fitoi 10,000 € dëmshpërblim.<sup>14</sup>

Ky rast është jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse gjykata ka vendosur gjashtë parime për të përcaktuar nëse e drejta e lirisë së shprehjes së sinjalizuesve duhet të mbrohet sipas Konventës Evropiane.<sup>15</sup>

13 <https://www.opensocietyfoundations.org/voices/how-one-courageous-whistle-blower-exposed-corruption-slovakias-government>

14 <https://see-whistleblowing.org>

15 <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-181203%22%7D>

### Rasti i Robert McCoy

Bëhet fjalë për person të punësuar nga Komiteti i Rajoneve që përfaqëson autoritetet lokale dhe rajonale në të gjithë Bashkimin Evropian dhe i këshillon ata për ligje të reja që kanë ndikim mbi rajonet dhe qytetet. Roberti ka zbuluar mashtrime dhe përvetësime të përhapura gjerësisht që asnjë nga menaxherët e lartë nuk kanë dashur t'i zbulojnë dhe kanë bërë përpjekje për t'i fshehur ato. Sipas pretendimeve të tij, drejtuesit kryesorë të organizatës, nuk kishin busull morale ndërsa kultura dhe qeverisja e tyre ishin mjaft të pandershme.<sup>16</sup> Roberti, duke mos mundur të jetë pjesë e një strukture të tillë dhe duke mos mundur të shohë rrezikimin e interesit publik, vendosi të publikojë një mënyrë të tillë funksionimi.

### Rasti i Dritan Hilës

Dritan Hila ka qenë i punësuar diplomat në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe ka raportuar emërimin e dyshimtë të vajzës së gjyqtarit për ambasadore. Pas zbardhjes së rastit, Hila u pushua nga puna, por vazhdoi të kërkonte drejtësi në procedurat gjyqësore për të fituar përsëri emërimin dhe kompensim financiar, dhe ishte i suksesshëm në këtë drejtim. Më vonë ai u emërua nga opozita Zëvendësministër i Mbrojtjes në Qeverinë Shqiptare.<sup>17</sup> Ky rast mund të jetë gjithashtu një shembull ilustrues për instrumentalizimin e politikave nga sinjalizuesit.<sup>18</sup>

<sup>16</sup> <https://whistleblowerprotection.eu/personal-stories/>

<sup>17</sup> <https://rm.coe.int/16806fffb0>, pp.15

<sup>18</sup> <https://see-whistleblowing.org/cases/>

## 2. Kapitulli i dytë – Raportimi i brendshëm i mbrojtur

### 2.1 Raportimi i brendshëm i mbrojtur – procedura

Raportimi i brendshëm i mbrojtur kryhet nga sinjalizuesi në institucion, përkatësisht në personin juridik, ku ekziston dyshimi ose informacioni se është kryer, po kryhet ose do të kryhet një veprë e ndëshkueshme, trajtim jo etik ose veprim tjetër i paligjshëm ose i papranueshëm që cenon ose rrezikon interesin publik.<sup>19</sup>

HAPI

01

Procedura rregullohet me Rregullore dhe fillon në atë mënyrë që sinjalizuesi rapor-ton gojarisht në procesverbal ose me shkrim tek personi i autorizuar në institucionin për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, ndërsa nëse në institucion, përkatësisht në personin juridik nuk ka person të autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, raportimi i bëhet drejtuesit të institucionit.

HAPI

02

Personi i autorizuar pranon raportimin dhe e regjistron atë në librin e posaçëm për regjistrim, duke vendosur një vulë katrore të posaçme për pranim.

HAPI

03

Nëse raportimi pranohet gojarisht, nëpunësi i autorizuar përpilon një procesverbal që përmban të dhëna për sinjalizuesin, të dhëna për personin ose subjektin ndaj të cilit sinjalizuesi raporton, përshkrim të procedurës së dënueshme ose të paligjshme dhe të papranueshme, që cenon ose kërcënon interesin publik të propozuar nga sinjalizuesi; mënyrën dhe formën e komunikimit midis sinjalizuesit dhe personit të autorizuar, bashkëngjitur datën dhe vendin e pranimit të raportit.

<sup>19</sup> Законот за заштита на укажувачите „Службен весник на РМ“ бр. 196/2015, 35/18, 257/20 чл. 4.



HAPI

04

Në rast se aplikimi dorëzohet në formë elektronike tek bartësi i regjistrimit elektronik, përkatësisht në mënyrë elektronike, personi i autorizuar do të shtypë procesverbalin, që korrespondon me raportimin sipas përmbajtjes, dhe dokumentin e shtypur me bashkëngjitjet, të nënshkruara e të pranuar në formën e regjistrave elektronikë, i regjistron si raportime të pranuar. Në rast se printimi i bashkëngjitjeve është joekonomik, personi i autorizuar i ruan ato në formë elektronike në kompjuterin e posaçëm, të pajisur me një fjalëkalim të njohur vetëm për të.

HAPI

05

Procedura vazhdon në mënyrë që nëpunësi i autorizuar do të hyjë në kërkesë me të gjitha bashkëngjitjet, do ta shqyrtojë atë, do ta studiojë përmbajtjen e saj dhe nëse nëpunësi i autorizuar konstaton se dokumenti ose procesverbali i pranuar nuk paraqet ose nuk i referohet raportimit të sinjalizuesit, për të njëjtën vendos menjëherë; në lëndën vendos shënim, të cilën e evidenton në librin e posaçëm për regjistrimin e lëndëve, mban një kopje të lëndës, ndërsa lëndën bashkë me dokumentet e bashkëngjitura në origjinal, e dorëzon me një letër përcjellëse në zyrën e nëpunësit të institucionit kompetent.

HAPI

06

Nëse, gjatë vlerësimit të përmbajtjes së raportimit, konstatohet se ai është logjik dhe i arsyeshëm, paraqet një raportim të sinjalizuesit, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe se raporti përmban elemente të mjaftueshme që të përcillet për procedim të mëtejshëm, personi i autorizuar, gjatë vlerësimit, mund të kërkojë gjithashtu informacion shtesë nga sinjalizuesi, nëse dihet, dhe të konsultohet me personë të tjerë, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së identitetit të sinjalizuesit.

HAPI

07

Pas kryerjes së vlerësimit, personi i autorizuar miraton konkluzione për veprime të mëtejshme lidhur me raportimin, të cilat u referohen kompetencës ose mos pas-jes së kompetencës për veprim të institucionit ku është caktuar raportimi dhe masat e nevojshme për veprim mbi raportimin. Në lidhje me insinuatat e përmbajtjes së raportimit dhe konkluzionet, personi i autorizuar pa prolongim, e informon personin përgjegjës. Megjithatë, me përjashtim, nëse personi i autorizuar gjatë vlerësimit arrin në përfundimin se pretendimet nga përmbajtja e raportimit janë drejtuar drejtpërdrejt ose tërthorazi kundër personit përgjegjës, raportimin ia përcjell institucionit kompetent (MPB, PThP, KSHPK, PK).

HAPI

08

Personi i autorizuar në institucionin ku është dorëzuar raportimi, për të cilin është kompetent të procedojë një institucion tjetër në përputhje me ligjin, duhet, jo më vonë se tetë ditë nga data e pranimit, të paraqesë kërkesën dhe t'ia përcjellë atë institucionit kompetent. Dhe, nëse është raportuar veprë penale kundër shtetit, kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare, në fushën e krimit të organizuar dhe për të cilin Kodi Penal parashikon dënim me burg prej së paku katër vjet, dëshmia e të cilit pasohet me vështirësi joproportionale ose nuk mund të kryhet pa deklaratën e sinjalizuesit, i cili, për shkak të rrezikut të mundshëm të ekspozimit ndaj frikësimit, kërcënimit nga hakmarrja ose rrezikut për jetën, shëndetin, lirinë, integritetin fizik ose pronën në shkallë më të madhe, nuk pajtohet në cilësinë e tij si dëshmitar të japë deklaratë, personi i autorizuar, me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit, i paraqet pa vonesë: - Minis-trisë së Punëve të Brendshme ose Prokurorit Publik kompetent, një iniciativë për paraqitjen e kërkesës me shkrim për paraqitjen e një propozimi për përfshirje në Programin për mbrojtje, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve ose - Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë të Veriut iniciativë për paraqitjen e një propozimi për përfshirje në Programin për mbrojtje, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe për përcjelljen e raportimit, e njofton sinjalizuesin, nëse dihet kush është sinjalizuesi.

HAPI

09

Procedura pas pranimit të raportimit, që i dërgohet një institucionit kompetent, për të cilin pas vlerësimit do të përcaktohet se është i logjikshëm, i arsyeshëm dhe përmban elemente të mjaftueshme për veprime të mëtejshme, nëpunësi i autorizuar do të marrë masa, brenda kompetencës së tij, për të vepruar mbi raportimin, përkatësisht do t'ia përcjellë kërkesën zyrtarit në institucionin përgjegjës për të vepruar në fushën me të cilën lidhet aplikimi, pasi të ketë veçuar më parë nga aplikimi të dhënat personale dhe të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit nëse ai/ajo ka kërkuar të mbetet konfidencial.

HAPI

10

Personi i autorizuar, me kërkesë të sinjalizuesit, e informon atë për rrjedhën dhe veprimet e ndërmarra në procedimet, lidhur me raportimin, dhe i mundëson sinjalizuesit të ketë këqyrje në procesverbalet e lëndës së formuar në bazë të raportimit të tij/saj. Për më tepër, mundësimi për këqyrje, përkatësisht qasje në informacionet lidhur me procedimin për raportimin, mund të ketë pasoja të dëmshme për rrjedhën e procedurës, personi i autorizuar do ta veçojë atë informacion dhe do ta informojë sinjalizuesin për këtë, dhe do t'i mundësojë këqyrje. Në fund, personi i autorizuar e njofton sinjalizuesin për rezultatin e procedurës për lëndën e formuar pas raportimit.

## 2.2 Shembuj praktikë

2.2.1 Një shembull raportimi të sinjalizuesit për raportim të brendshëm mund të jetë kur një punonjës i një institucioni publik, më saktësisht në sektorin e prokurimit publik dhe të financave, gjatë funksionimit të tij, vëren se një kompani e caktuar është fituese e shpeshtë e tenderëve nga ai institucion, dhe kjo ndodh kur komisioni i prokurimit publik përbëhet nga të njëjtët persona, ndërsa çmimet për shërbimet janë disa herë më të larta se ato të zakonshmet për këtë prokurim. Në të njëjtën kohë, është simptomatike që ajo kompani të fitojë tenderin sa herë që vendos për të, përbërja e përcaktuar e komisionit dhe pothuajse gjithmonë ajo kompani mbetet ofertuesi i vetëm. Duke pasur parasysh këtë situatë që përsëritet disa herë, sinjalizuesi mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme se bëhet fjalë për një veprim të paligjshëm nga ndonjëri prej anëtarëve të komisionit për prokurim publik dhe rrjedhimisht t'i tregojë ose t'i paraqesë personit të autorizuar raport sipas Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve për pranimin e raporteve në institucion.

2.2.2 Një shembull tjetër i sinjalizuesit për raportim të brendshëm të mbrojtur mund të jetë kur personi i punësuar në një institucion publik për një periudhë të gjatë kohore vëren që disa nga punonjësit në institucion nuk respektojnë orarin e punës, përkatësisht punojnë më shkurt se orari i parashikuar, duke lënë punën më herët, ose disa të punësuar nuk paraqiten fare në vendin e punës, ndërsa ngarkesa e punës rritet në kurriz të atyre që përmbushin rregullisht detyrimet e punës dhe interesi publik rrezikohet përmes zgjidhjes joefikase dhe të parakohshme të lëndëve të qytetarëve, për këto arsye punonjësi vendos të raportojë këtë situatë, duke paraqitur një raportim sinjalizuesi tek personi i autorizuar në institucion për pranimin e raporteve të sinjalizuesve.

2.2.3 Shembull i një raporti të sinjalizuesit që nuk plotëson kushtet për t'u trajtuar në bazë të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve është kur një person që ka qenë i punësuar me kontratë për punësim të përkohshëm në një institucion publik raporton keqpërdorim të autorizimit zyrtar nga personi përgjegjës i atij institucioni sepse personi udhëheqës nuk e ka zgatur kontratën e saj të punës dhe arsyeja për këtë është se e punësuar është në fazën e hershme të shtatzënisë. Në situatë të tilla dhe të ngjashme, kur merret parasysh përmbajtja e raportimit, personi i autorizuar do të përcaktojë se nuk bëhet fjalë për raportim në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe do ta paraqesë atë së bashku me dokumentet e tjera të lëndës, në sekretarinë e institucionit ku është bërë kërkesa, për procedim të mëtejshëm në

përputhje me ligjet e tjera, me ç'rast ka arsye për të vepruar në përputhje me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.<sup>20</sup>

2.2.4. Shembull tjetër i raportimit të sinjalizuesit që nuk i plotëson kushtet për t'u trajtuar në bazë të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve është kur një punonjës në një institucion publik ka mosmarrëveshje me një nga kolegët në vendin e punës për një periudhë të caktuar kohore, duke qenë vazhdimisht i ekspozuar ndaj komenteve negative nga ai punonjës, dhe për shkak të një situatë të tillë, është e vështirë për të, që të kryejë detyrat e rregullta të punës, dhe një i punësuar vendos të paraqesë raportim sinjalizuesi tek personi i autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve. Megjithatë, në situatën e caktuar ose të ngjashme, gjatë vlerësimit të kërkesës, personi i autorizuar do të kuptojë se nuk bëhet fjalë për raportim që mund dhe duhet të trajtohet në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe do ta paraqesë atë së bashku me dokumentet e tjera të lëndës, në sekretarinë e institucionit ku është bërë kërkesa për veprime të mëtejshme në përputhje me ligjet e tjera, me ç'rast ekziston bazë për veprim në përputhje me Ligjin për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës.<sup>21</sup>

20 Shembujt e dhënë janë situata hipotetike të imagjinuara dhe shërbejnë për ta bërë më të lehtë për nëpunësin e autorizuar të njohë kur vlerëson nëse është një raportim që mund të trajtohet sipas Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.

21 Ligji për mbrojtjen nga ngacmimi në punë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2013 dhe 147/2015).

## 3. Kapitulli tre – Raportimi i jashtëm i mbrojtur

### 3.1 Raportimi i jashtëm i mbrojtur – procedura

Në dallim nga raportimi i brendshëm i mbrojtur që kryhet brenda institucionit për të cilin raportohet një veprim ose keqpërdorim i caktuar i paligjshëm, në raportimin e jashtëm të mbrojtur, ai bëhet jashtë në një institucion tjetër që mund dhe ka juridiksion për të vepruar mbi raportin në fjalë.

Procedura për raportim të jashtëm të mbrojtur fillon me sinjalizuesin, që bën raportim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurorinë Publike kompetente, Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë të Veriut ose në institucione të tjera kompetente, gjegjësisht persona juridikë, për shembull në shërbimet e inspektimit.<sup>22</sup>

Megjithatë, për të kryer një raportim të jashtëm të mbrojtur, duhet të përmbushet një nga kërkesat ligjore të parashikuara:

- kur raportimi i brendshëm i mbrojtur i referohet drejtpërdrejt ose tërthorazi kundër personit udhëheqës në institucion, përkatësisht subjektit juridik ku raporton ose
  - sinjalizuesi në lidhje me raportimin e brendshëm të mbrojtur nuk merr informacion për masat e ndërmarra brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të raportimit
  - nuk janë marrë masa ose sinjalizuesi nuk është i kënaqur me veprimin ose dyshon se nuk do të merren masa, apo që raportimi i brendshëm i mbrojtur do të shkaktojë pasoja të dëmshme atij ose asaj, apo një personi të afërt.
- ✓ Personi i autorizuar bën pranimin e raporteve të paraqitura drejtpërdrejt tek ai/ajo nga një sinjalizues për qëllime të raportimit të jashtëm të mbrojtur ose të paraqitura nga një person i autorizuar për qëllim të pranimin të raporteve, me qëllim të raportimit të brendshëm të mbrojtur nga një institucion tjetër. Regjistrimi i raporteve të pranuar kryhet nga personi i autorizuar me vendosjen e një vule të veçantë katrore për pranim dhe evidentim në librin e posaçëm të të dhënave.
- ✓ Pas pranimin të raportimit, nëpunësi i autorizuar fillon procedurën e procedimit të kërkesës në mënyrë që<sup>23</sup>:

<sup>22</sup> Ligji për mbrojtjen e denoncuesve Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 196/2015 dhe 35/18 neni 5

<sup>23</sup> Rregullore për raportimin e mbrojtur të jashtëm, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46, datë 8.03.2016

HAPI

01

Raportimi duhet të evidentohet me të gjitha bashkëngjitjet dhe të shqyrtohet përm-bajtja e saj, dhe nëse personi i autorizuar konstaton se nuk bëhet fjalë për raportim sinjalizuesi, për këtë vendoset shënim, i cili duhet të regjistrohet në librin e posaçëm të procesverbalit, ndërsa lënda duhet të dorëzohet në sekretarinë e institucionit kompetent, me çka përfundon procedimi sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.

HAPI

02

Personi i autorizuar bën vlerësim të raportimit për të përcaktuar nëse është i arsyeshëm, logjik dhe përmban elemente të mjaftueshme për t'u trajtuar si raportim i sinjalizuesit; në këtë fazë, personi i autorizuar mund të kërkojë gjithashtu informacion shtesë nga sinjalizuesi dhe të konsultohet me persona të tjerë, por është e rëndësishme të merret parasysh mbrojtja e identitetit të sinjalizuesit. Pas këtij vlerësimi, personi i autorizuar nxjerr konkluzione në lidhje me kompetencën dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë.

HAPI

03

Në rast se institucioni nuk është kompetent për të vepruar, nëpunësi i autorizuar paraqet kërkesën në institucionin kompetent brenda 8 ditëve.

HAPI

04

Një hap i rëndësishëm në procedurën që duhet të merret në konsideratë është në rastin kur raportohet një veprë penale kundër shtetit, kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare, në fushën e krimin të organizuar dhe për të cilin Kodi penal parashikon dënim me burg prej të paktën katër vjet dhe ekziston rreziku ose hakmarrja ndaj jetës së sinjalizuesit, atëherë pas sigurimit të pëlqimit të tij, dorëzohet iniciativë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose Prokurorinë Publike për paraqitjen e Propozimit për përfshirje në Programin për mbrojtje në përpunje me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

HAPI

05

Hapi i fundit në procesin e raportimit për të cilin pas kryerjes së vlerësimit, është përcaktuar se është i arsyeshëm, logjik dhe përmban elemente të mjaftueshme që personi i autorizuar të marrë masa në kompetencën e tij për të vepruar në lidhje me raportimin, përkatësisht ia përcjell raportimin një zyrtari në institucionin përgjegjës për të vepruar në fushën me të cilën lidhet raportimi pasi të ketë veçuar më parë të dhënat personale dhe të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit. Kështu personi i autorizuar, me kërkesë të sinjalizuesit, e informon atë për rrjedhën dhe veprimet e ndërmarra në procedimet lidhur me raportimin dhe i mundëson sinjalizuesit të ketë këqyrje në procesverbalet e lëndës.

### 3.2 Shembuj praktikë

3.2.1. Shembull i raportimit të jashtëm të mbrojtur është kur një person i punësuar në institucion, për një periudhë të gjatë, vihet në dijeni se udhëheqësi i institucionit përdor mjetin zyrtar jashtë orarit të punës, me këtë mjet shkon në shtëpi pas përfundimit të orarit të punës dhe e përdor atë edhe në fundjavë për qëllime private dhe udhëtime. Punonjësi i punësuar në institucionin, në pamundësi për të toleruar që burimet shtetërore të keqpërdoren për qëllime private dhe të rrezikojnë drejtpërdrejt interesin publik, vendos të vërë në dukje këtë situatë, por duke qenë se raportimi drejtohet kundër udhëheqësit të institucionit, nuk ia paraqet personit të autorizuar për pranimin e raportimeve nga sinjalizuesit, por ia paraqet Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

3.2.2. Një shembull tjetër i raportimit të jashtëm të mbrojtur është kur sinjalizuesi vihet në dijeni të trajtimit të paligjshëm ose prokurimit të kryer të mallrave dhe shërbimeve pa kryer procedurën e nevojshme për tenderim në institucion. Në ekzekutim janë përfshirë edhe personat udhëheqës, ndërkaq ekziston rreziku që një pjesë ose të gjitha provat mund të fshihen ose të shkatërrohen nëse kalon një periudhë më e gjatë kohore, kështu që nëse informatori raporton ose i vë në dukje ato ngjarje drejtpërdrejt në institucion, atëherë ai e vë veten në rrezik të drejtpërdrejtë. Për këto arsye, është vendosur të përdoret raportimi i jashtëm i mbrojtur për të raportuar këto zhvillime në Prokurorinë Publike kompetente.

## 4. Kapitulli i katërt – Raportimi publik i mbrojtur

Me dy llojet e mëparshme të raportimit, përkatësisht raportimit të brendshëm të mbrojtur dhe raportimit të jashtëm të mbrojtur, përdoren kanalet institucionale të raportimit dhe veprimet, të krijuara në mënyrë sistematike nga institucionet kompetente. Ndërsa te raportimi publik i mbrojtur, për shkak të urgjencës, rrezikut ose dështimit të institucioneve, sinjalizuesi ndan informacione në sferën publike.

### 4.1 Raportimi publik i mbrojtur – procedura

- ✓ Raportimin publik të mbrojtur një sinjalizues mund ta bëjë duke vënë në dispozicion të publikut informacione, zakonisht përmes mjeteve të informimit publik në lidhje me njohuritë se është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet vepër penale e dënueshme, që cenon ose kërcënon jetën e informatorit dhe të afërmeve të tij, shëndetin e njerëzve, sigurinë, mjedisin, dëme në shkallë të gjerë, përkatësisht nëse ekziston rrezik i menjëhershëm i shkatërrimit të provave.<sup>24</sup>
- ✓ Në rastin e raportimit publik, është e rëndësishme që procedura të përmbajë disa nga kërkesat ligjore të parashikuara, të cilat përmbushen, përkatësisht:
  - duhet të ketë kërcënim të drejtpërdrejtë për jetën e sinjalizuesit,
  - të bëhet fjalë për dëm serioz për shëndetin e njeriut ose mjedisin jetësor, ose
  - të ekzistojë rreziku i shkatërrimit të provave.
- ✓ Këto kushte nuk duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe ekzistenca e vetëm njërit prej kushteve të listuara është e mjaftueshme. Megjithatë, asaj që sinjalizuesi në këtë procedurë duhet t'i kushtojë vëmendje është fakti se ai duhet të ketë raportuar më parë përmes mekanizmave të raportimit të brendshëm të mbrojtur ose raportimit të jashtëm të mbrojtur, në mënyrë që të mos humbasë të drejtat për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe mbrojtjen gjyqësore që ata gëzojnë sipas ligjit.
- ✓ Një element tjetër i rëndësishëm i procedurës gjatë raportimit publik të mbrojtur është se sinjalizuesi, në bërjen publike të informacioneve të qasshme, është i detyruar të respektojë prezumimin e pafajësisë së personit për të cilin ka bërë raportimin, të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të personit për të cilin ka bërë raportimin, si dhe të mos rrezikojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Në këtë procedurë, mund të jetë e këshillueshme që sinjalizuesi të konsultohet me një këshilltar juridik ose avokat në lidhje me respektimin e prezumimit të pafajësisë dhe informacionet që janë të rëndësishme për procedurat gjyqësore.

<sup>24</sup> Законот за заштита на укажувач/укажувака, „Службен весник на РМ“ 196/2015 и 35/18 чл. 5

## 4.2 Shembuj praktikë

Një shembull i raportimit publik të mbrojtur është kur një nëpunës doganor vjen në dijeni se një dërgesë, që në fakt përmban mbetje helmuese me rrezik të lartë, duhet të importohet në vend dhe menjëherë pas importit duhet të shkatërrohet në një vend specifik. Më pas nëpunësi doganor kupton se kjo është në marrëveshje me disa nga kolegët dhe eprorët e tij dhe afati kohor për ekzekutim është vetëm 2 ditë.

Në këtë rast, nëpunësi, pasi ka përdorur më parë mekanizmin e raportimit të jashtëm të mbrojtur, mundet, për shkak të urgjencës së situatës dhe mungesës së reagimeve, të bëjë gjithashtu një raportim publik të mbrojtur dhe të informojë në mënyrë anonime përmes mediave për rastin, me qëllim shmangien e dëmtimit në shkallë të gjerë dhe rrezikut për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Gjatë kësaj, nëpunësi doganor kujdeset që informacionet të cilat ai ndan, t'i referohen aktivitetit specifik të paligjshëm/të paautorizuar që kryhet pa specifikuar të dhënat për personat e përfshirë.

# 5. Kapitulli i pestë – Mbrojtja e sinjalizuesve

Një nga elementet më të rëndësishme në procesin e zbatimit të ligjit dhe të rregullave për mbrojtjen e sinjalizuesve është procedura për mbrojtjen e sinjalizuesve sepse është jashtëzakonisht e nevojshme, kryesisht për mbrojtjen e personit që inkurajohet të raportojë veprime të paligjshme, të paautorizuara, jo etike ose ndëshkuese, por edhe për përpunimin e suksesshëm të rastit të raportuar.

Kështu, dallohen dy lloje të mbrojtjes, përkatësisht mbrojtja e zbatuar nga personi i autorizuar për pranimin e raportimeve nga sinjalizuesit brenda institucionit dhe mbrojtja nga gjykatat në procedura të caktuara gjyqësore. Për llojin e parë të mbrojtjes, personat e autorizuar duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe të ndjekin hapat e nevojshëm, kryesisht në mbrojtjen e të dhënave personale dhe identitetit të sinjalizuesit.

## 5.1 Mbrojtja e të dhënave dhe identitetit të sinjalizuesve

- ✓ Për të siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe identitetin e sinjalizuesve, ndalohet zbulimi ose mundësimi i zbulimit të identitetit të sinjalizuesve pa pëlqimin e tij, përveç kur kërkohet me vendim gjykate, kur është e nevojshme për t'u zhvilluar procedura para një autoriteti kompetent.
- ✓ Gjatë gjithë procedurës, personi i autorizuar për pranimin e raportimeve të sinjalizuesve është i detyruar të mbrojë të dhënat e sinjalizuesve, përkatësisht të dhënat mbi bazën e të cilave mund të zbulohet identiteti i sinjalizuesve, përveç nëse sinjalizuesi pajtohet për zbulimin e këtyre të dhënave, dhe në përputhje me një ligj që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✓ Megjithatë, duhet të theksohet se jo vetëm personi i autorizuar, por çdo person, i cili gjatë procedurës, mëson të dhënat dhe identitetin e sinjalizuesit është i detyruar t'i mbrojë ato të dhëna.
- ✓ Në rast se zbulimi i identitetit të sinjalizuesit bazohet në një vendim gjyqësor, personi i autorizuar për pranimin e raportimeve të sinjalizuesve është i detyruar ta njoftojë sinjalizuesin përpara zbulimit të identitetit.

## 5.2 Ofrimi i mbrojtjes sinjalizuesve

Për sinjalizuesin dhe personat e tij të afërt parashihet edhe mbrojtje gjyqësore nga çdo lloj i shkeljes të së drejtës, gjatë përcaktimit të përgjegjësisë, sanksionit, ndërprerjes së marrëdhënies së punës, pezullimit nga puna, transferimit në një punë tjetër që është më pak e favorshme, diskriminimit ose veprimit të dëmshëm ose rrezikut nga veprime të dëmshme, për shkak të raportimit të brendshëm dhe të jashtëm të mbrojtur ose raportimit publik të mbrojtur.

Procedura e mbrojtjes bëhet dhe sigurohet nga institucioni, përkatësisht nga personi juridik ku është bërë raportimi, duke ndërmarrë veprime për të parandaluar shkeljen e të drejtave të marrëdhënies së punës ose të çdo të drejte tjetër dhe përmbajtja nga veprime që cenojnë ose kërcënojnë çdo të drejte të sinjalizuesit për shkak të raportimit.

Në rast se kjo mbrojtje nuk zbatohet dhe nuk sigurohet nga institucioni, sinjalizuesi për këtë duhet të raportojë te:

- Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit,
  - Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
  - Këshilli Inspektues,
  - Ministria e Punëve të Brendshme dhe
  - Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- ✓ Hapi tjetër, pas pranimit të një raportimi të tillë është të kërkohet menjëherë njoftimi për ekzistencën e çdo lloj shkeljeje të së drejtës së sinjalizuesit dhe familjarëve të tij, për shkak të raportimit të bërë nga institucioni, përkatësisht subjekti juridik ku është bërë raportimi. Ndërkaq subjekti juridik, përkatësisht institucioni, është i detyruar të veprojë pa vonesë në lidhje me raportimin, dhe jo më vonë se tetë ditë, për këtë të paraqesë një njoftim.
- ✓ Pas këtij njoftimi, nëse vërtetohet se institucioni, përkatësisht subjekti juridik ku është bërë raportimi, ka shkelur të drejtën e sinjalizuesit, të një anëtari të familjes së tij ose të afërmeve të tij, institucionet (KSHPK, PP, MPB, KI) u drejtohen menjëherë institucioneve dhe autoriteteve kompetente me kërkesë me shkrim, për masa të menjëhershme për mbrojtjen e sinjalizuesit me ndërprerje të veprimeve, përkatësisht shmangien e lëshimeve që cenojnë të drejtat e sinjalizuesit. Për këtë, pa prolongim e njoftojnë sinjalizuesin.
- ✓ Nëse shkelja vazhdon, pavarësisht hapit të ndërmarrë më parë, atëherë menjëherë, dhe jo më vonë se tetë ditë, ndërmarrin nismë për fillimin e procedimit për ndjekje penale, përkatësisht nismë për fillimin e procedimit para autoriteteve kompetente për shkarkimin, transferimin, zëvendësimin ose zbatimin e masave të tjera të përgjegjësive për personat e zgjedhur ose të emëruar, nëpunësit ose personat përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe personat e tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror.
- ✓ Këtu duhet të dallohet situata kur është raportuar një vepër penale kundër shtetit, kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare, në fushën e krimit të organizuar dhe për të cilin Kodi penal parashikon dënim me burgim të paktën katër vjet, vërtetimi i të cilit pasohet nga vështirësi joproporcionale ose nuk mund të kryhet pa deklaratën e sinjalizuesit, i cili për shkak të rrezikut të mundshëm të ekspozimit ndaj kërcënimit, kërcënimit të hakmarrjes ose rrezikut të jetës, shëndetit, lirisë, integritetit fizik ose pasurisë në një shkallë më të madhe, nuk pajtohet në cilësinë e tij si dëshmitar për të dhënë deklaratë, institucionet, me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit i paraqesin:
- Ministrisë së Punëve të Brendshme ose Prokurorit Publik kompetent iniciativë për paraqitjen e kërkesës me shkrim për paraqitjen e Propozimit për përfshirje në Programin për mbrojtje, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve ose
  - Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut iniciativë për paraqitjen e Propozimit për përfshirje në Programin për mbrojtje, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

### 5.2.1 Shembuj praktikë

*Sinjalizuesi (punonjës i një institucioni publik) paraqet raportim në KSHPK dyshimin për paligjshmëri dhe parregullsi të kryera në punën e drejtorit të një institucioni publik. Nga komunikimi i drejtpërdrejtë me sinjalizuesin, përcaktohet se ka pasur mosmarrëveshje dhe komunikim të rënduar midis drejtorit dhe sinjalizuesit edhe para raportimit të mbrojtur, prandaj drejtori ndoshta supozoi se cili person mund të jetë sinjalizuesi. Sinjalizuesi gjithashtu paraqet në KSHPK, Kërkesë për mbrojtjen e tij.*

*Pas pranimit të raportimit dhe evidentimin e tij, si dhe pas vlerësimit të përmbajtjes së tij, personi i autorizuar për raportim të jashtëm të mbrojtur në KSHPK ndërmerr veprime - paraqet kërkesë për mbledhjen e të dhënave në institucione të tjera kompetente, për të verifikuar pretendimet në raportimin dhe për të përcaktuar situatën faktike në rastin e raportuar.*

*Pas fillimit të procedimit nga autoriteti tjetër kompetent, i cili ka kërkuar të inspektojë dokumentacionin në ndërmarrje, drejtori ka ndërmarrë masa ndaj sinjalizuesit - dhe i ka dorëzuar atij vendim për transferim në një vend tjetër pune, më shumë se 50 km larg Shkupit. Për këtë, sinjalizuesi/sinjalizuesja informon personin e autorizuar në KSHPK, pas së cilës nga drejtori i institucionit në fjalë kërkohet të vendosë për arsyet e marrjes së vendimit për vendosjen e sinjalizuesit/sinjalizueses në një vend tjetër pune - nuk është marrë asnjë përgjigje.*

*Në të njëjtën kohë, janë dorëzuar kërkesa për veprime kompetente në shërbimet e inspektimit për mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e legjislacionit lidhur me vendimin e miratuar për transferimin e sinjalizuesit/sinjalizueses - **institucionet kanë vepruar në afatin e përcaktuar ligjor dhe kanë konstatuar se kishte shkelje të normave ligjore në lidhje me vendimin e miratuar.***

*Si rezultat i veprimeve të shërbimeve të inspektimit, drejtori tërhoqi vendimin për transferim dhe e ktheu punëtorin në punën e tij, por drejtori kundër sinjalizuesit fillon një procedurë disiplinore, e cila përfundon me miratimin e një vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të sinjalizuesit në ndërmarrje.*

*Pas pranimit të informacioneve se ndaj sinjalizuesit është filluar një procedurë disiplinore, KSHPK i kërkon drejtorit të deklarojë veprimet e ndërmarra, i cili jep përgjigje të arsyetuar me dokumentacion për shkelje të rendit të punës dhe disiplinës nga sinjalizuesi.*

*Sinjalizuesi gjithashtu inicion kontest pune përpara gjykatës kompetente, ku kërkon mbrojtje gjyqësore, që zgjati më shumë se dy vjet dhe përfundoi në mënyrë që sinjalizuesi kthehet në vendin e tij/saj të punës.*

*Ndërkohë, institucionet e tjera kompetente po veprojnë sipas pretendimeve në raportin e sinjalizuesit, dhe pas dorëzimit të përgjigjeve dhe dokumentacionit të bashkangjitur, që tregon se ka bazë për pretendimet në raportin e paraqitur, KSHPK inicion Iniciativë drejtuar Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për të vendosur përgjegjësi ndaj drejtorit të ndërmarrjes publike dhe një Iniciativë për ndjekje penale në Prokurorinë Themelore Publike Shkup. Procedimi për të dyja nismat është ndërprerë për shkak të ndryshimit të situatës faktike, (vdekja e personit të raportuar - drejtorit).*

### 5.3 Mbrojtja gjyqësore

Përveç mbrojtjes që sinjalizuesi gëzon gjatë procedurës, dhe për të cilën personi i autorizuar për pranim nga sinjalizuesit duhet ta kryejë ex officio dhe me vëmendje të lartë dhe me përgjegjësi, sinjalizuesi ka një të drejtë tjetër të rëndësishme për mbrojtje, e cila është të kërkojë mbrojtje gjyqësore përpara një gjykate kompetente në një procedurë civile.

Sinjalizuesi mundet, përpara një gjykate civile kompetente në **një procedurë që është urgjente**, me padi, të kërkojë:

- përcaktimin se është ndërmarrë një veprim i dëmshëm apo se është shkelur një e drejtë për shkak të raportimit të mbrojtur;
- ndalimin e kryerjes së një veprimi të dëmshëm ose shkeljes së një të drejte për shkak të raportimit të mbrojtur dhe përsëritjes së një veprimi të dëmshëm ose shkeljes së një të drejte;
- shfuqizimin e një akti që ka kryer veprën e dëmshme ose shkeljen e një të drejte për shkak të raportimit të mbrojtur;
- heqjen e pasojave të një veprimi të dëmshëm ose shkeljes së një të drejte me qëllim të raportimit të mbrojtur;
- kompensimin e dëmeve materiale dhe jomateriale për shkak të raportimit të mbrojtur.

Barra e provës, në rast të mosmarrëveshjes për ekzistencën e shkeljes së të drejtës së sinjalizuesit dhe të afërmeve të tij/saj për shkak të raportimit është në anën e institucionit, dhe në procedurën për mbrojtje gjyqësore në lidhje me raportimin, lejohet kontroll në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### 5.4 Keqpërdorim i raportimit të sinjalizuesve

Ligji rregullon keqpërdorimin e raportimit të sinjalizuesve dhe kjo është gjithashtu një situatë e rëndësishme që duhet të identifikohet nga persona të autorizuar për pranimin e raporteve, por është e nevojshme që vetë sinjalizuesit të jenë të vetëdijshëm për këto dispozita të ligjit dhe pasojat e mundshme.

Përndryshe, keqpërdorimi përkufizohet si **raportim me vetëdije i informacioneve të pavërteta për një person fizik ose juridik, me qëllim që të shkaktojë pasoja të dëmshme për të**. Gjithashtu keqpërdorim të raportimit të sinjalizuesve paraqet edhe nëse, me kujdesin dhe ndërgjegjen e duhur, në masën që lejojnë rrethanat, sinjalizuesi nuk ka kontrolluar nëse ato janë të sakta dhe të besueshme.

Për shembull, një sinjalizues, për një periudhë më të gjatë, mund të jetë në marrëdhënie të tensionuar dhe armiqësore me ndonjë koleg/kolege të caktuar ose me mbikëqyrësin në vendin e punës, dhe rrugëdalje ose hakmarrje për këtë situatë kërkon përmes Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe duke raportuar informacione të pavërteta ose të kurdisura, bën keqpërdorim të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.

Në parandalimin ose zbulimin e situatave të tilla, personat e autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve kanë një rol të rëndësishëm në pjesën e procedurës, gjatë vlerësimit të përmbajtjes së raportit dhe nëse, bazuar në prima facie fillestare, dyshojnë në besueshmërinë e pretendimeve të bëra, është e nevojshme që sinjalizuesit t'ia bëjnë me dije dispozitat ligjore dhe pasojat nga keqpërdorimi i raportimit.

Është e rëndësishme të theksohet se nëse konstatohet keqpërdorimi, mund ta humbasë statusin e sinjalizuesit dhe mbrojtjen që i ofrohet në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve, dhe nëse keqpërdorimi i raportimit të sinjalizuesve ka shkaktuar pasoja të dëmshme për personin fizik ose juridik, kjo është baza për fillimin e një procedure për përcaktimin e përgjegjësisë së tij.

## 6 Kapitulli i gjashtë – Statistikat për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve

Sipas Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, institucionet dhe personat juridikë nga sektori privat janë të detyruar të caktojnë persona të autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve për raportim të mbrojtur.

Personi i autorizuar, përgatit një raport gjashtëmujor për raportet e sinjalizuesve, që përmban statistika të përgjithshme, si numri i përgjithshëm i raporteve të pranuar, numri i përgjithshëm i sinjalizuesve, numri i sinjalizuesve anonimë, numri i sinjalizuesve konfidencialë si dhe të dhëna për rastet e formuara sipas raporteve të pranuar. Raportet gjysmë vjetore dorëzohen në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dy herë në vit, për gjashtë muajt e parë, në korrik të vitit aktual, dhe për gjashtë muajt e dytë për vitin paraardhës, në janar të vitit aktual.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka krijuar gjithashtu një regjistër të personave të autorizuar për pranimin e raporteve të sinjalizuesve, i cili azhurnohet rregullisht. Sipas të dhënave të fundit për vitin 2022, nga 1324 institucione të sektorit publik, gjithsej 200 kanë caktuar një person për pranimin e raportimeve të sinjalizuesve.<sup>25</sup> Ndërsa gjithsej 118 institucione dorëzuan raporte gjysmë vjetore, me të dhëna për raportet e pranuar.<sup>26</sup>

Nga ana tjetër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është i detyruar të paraqesë raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për raportet e pranuar nga sinjalizuesit, në kuadër të Raportit të tij vjetor të punës. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit e përmbush rregullisht këtë detyrim dhe raportet me të dhëna të hollësishme statistikore publikohen në ueb faqen e tij.<sup>27</sup>

Këto të dhëna tregojnë se numri i raporteve të sinjalizuesve për raportimin e brendshëm të mbrojtur dhe për raportimin e jashtëm të mbrojtur është ende i pamjaftueshëm dhe është e nevojshme të forcohet më tej roli i personave të autorizuar, si dhe të promovohen kanalet e përcaktuara të raportimit.

<sup>25</sup> Raporti vjetor për punën e KSHPK-së për vitin 2022

<sup>26</sup> Në raportet gjysmë-vjetore të dorëzuara për gjysmën e parë të vitit 2022, katër (4) institucione raportuan se personat e autorizuar në ato institucione pranuan gjithsej 17 raporte të sinjalizuesve, mbi të cilat u ndërmorën veprime dhe masa në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe aktet nënligjore. Ndërsa në gjysmën e dytë të vitit 2022, pesë (5) institucione raportuan se kanë pranuar 7 raportime dhe kanë vepruar në përputhje me ligjin.

<sup>27</sup> <https://dksk.mk/mk/%d0%b3%d0%be%d0%b4%d0%b8%d1%88%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8/>

## Përfundim

Sinjalizuesit, me veprimin dhe integritetin e tyre, qëndrojnë në mbrojtje të interesit publik dhe të së mirës së përbashkët. Prandaj, është e nevojshme të sigurohen mënyra të sakta dhe të rregullta të raportimit të rasteve të tilla, si dhe mbrojtje adekuate të sinjalizuesve. Sipas rregulloreve dhe akteve nënligjore pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ekzistojnë dhe janë rregulluar procedura për tri lloje të raportimit: raportimi i brendshëm i mbrojtur, raportimi i jashtëm i mbrojtur dhe raportimi publik i mbrojtur. Në të gjitha këto procedura, roli i personave të autorizuar për pranimin e raportimeve të sinjalizuesve është i një rëndësie thelbësore. Në përputhje me rrethanat, Udhëzuesi shtjellon në detaje procedurat për pranimin e raportimeve të sinjalizuesve, si dhe rolin dhe kushtet e nevojshme teknike dhe hapësinore që duhet të sigurohen për zbatimin pa probleme të ligjit nga personat e autorizuar për pranimin e raportimeve të sinjalizuesve. Për më tepër, Udhëzuesi përmban shembuj të dobishëm nga praktika ndërkombëtare, si dhe skenarë të mundshëm të zhvilluar, që do të jenë të dobishëm në vlerësimin dhe evaluimin e raporteve nga personat e autorizuar për pranimin e raportimeve nga sinjalizuesit. Qëllimi i Udhëzuesit është të ndihmojë dhe të lehtësojë ndjeshëm trajtimin e personave të autorizuar për marrjen e raporteve të sinjalizuesve, përpunimin e tyre si dhe mbrojtjen adekuate të sinjalizuesve.